

TAKIMI I DYTË 2026 - KOMITETI SEKTORIAL I ENERGJISË

Mbledhja e dytë e Komitetit Sektorial të Energjisë u mbajt më datë **26.05.2026**.

Takimi kishte në fokus prezantimin e Studimit të Nevojave për Aftësi digjitale dhe të gjelbra në sektorin e energjisë, prezantimin dhe diskutimin e strukturës aktuale të kualifikimeve profesionale në fushën e Elektroteknikës, si dhe validimin e dokumenteve të hartuara nga AKAFPK.

Në pjesën e parë të takimit, një nga anëtarët e Komitetit Sektorial, prezantoi gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi digjitale dhe të gjelbra në sektorin e energjisë, që ishte realizuar vitin e kaluar. Studimi ishte mbështetur në pesë shtylla kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik: sigurimin e energjisë, integrimin në tregun rajonal dhe europian, efikasitetin energjetik, mbrojtjen e mjedisit, si dhe nxitjen e inovacionit dhe konkurrueshmërisë. Metodologjia e përdorur për Studimin bazohej në mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve cilësorë dhe sasiorë (online dhe fizikisht), si dhe në grumbullimin e informacionit dhe dokumentacionit të gjerë për krijimin e një baze të dhënash të nevojshme për vlerësimin e situatës. Nga Studimi rezultonte se, në sektorin e energjisë, aftësitë e gjelbra lidhen ngushtë me aftësitë digjitale, pasi teknologjitë si: IoT, SCADA dhe platformat digjitale kërkojnë personel të pajisur me kompetenca të avancuara.

Studimi tregoi se, aftësitë digjitale më të kërkuara nga kompanitë janë: analiza e të dhënave, monitorimi, lidhja me pajisjet inteligjente, SCADA etj. Përsa i përket aftësive të gjelbra rezultonte se, prioritetet kryesore ishin: energjia diellore, efikasiteti energjetik, hidroenergjia, energjia e erës, ruajtja dhe akumulimi i energjisë. Sa i përket sfidave kryesore të sektorit ishin identifikuar: mungesa e stafit të kualifikuar, stimujt e pamjaftueshëm financiarë, barrierat ligjore, informimi i pamjaftueshëm, buxhetet e kufizuara dhe infrastruktura e rrjetit.

Krahas kësaj nga gjetjet e Studimit, rezultonte që tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital ishin informacione të rëndësishme jo vetëm për sektorin e energjisë, por edhe për sektorë të tjerë. Në këtë kuadër, anëtarët e Komitetit u informuan se, në kuadër të procesit të validimit të skeletkurrikulave për “*Multimedia*”, “*Programim*”, “*Zhvillimi website*” dhe “*Tregti e-commerce (elektronike)*”, vlerësohej se integrimi i aftësive të gjelbra përbënte një element thelbësor për përafrimin e arsimit dhe formimit profesional me kërkesat e tregut të punës dhe objektivat e tranzicionit të gjelbër. Për këtë arsye, gjatë shqyrtimit të kurrikulave ishte konstatuar rëndësia e përfshirjes së koncepteve që lidhen me Green IT, zhvillimin e qëndrueshëm të aplikacioneve dhe faqeve të internetit, menaxhimin e përgjegjshëm të infrastrukturës dhe të dhënave digjitale, si dhe praktikatat e qëndrueshme në tregtinë elektronike dhe komunikimin digjital.

Anëtarët u informuan se, këto profile profesionale kishin potencial të konsiderueshëm për të kontribuar në zhvillimin e praktikave të qëndrueshme përmes përdorimit efikas të teknologjisë, optimizimit të burimeve digjitale, reduktimit të konsumit të energjisë dhe promovimit të zgjidhjeve

inovative me ndikim më të ulët mjedisor. Po kështu, rëndësi të veçantë kishte sigurimi që kompetencat e parashikuara të mos mbeteshin vetëm në nivel teorik, por të zhvilloheshin përmes aktiviteteve praktike, projekteve dhe situatave reale të punës, duke i pajisur nxënësit me aftësitë e nevojshme për të kontribuar aktivisht në ekonominë e gjelbër.

U theksua se, kontributi i anëtarëve të Komitetit Sektorial ishte i rëndësishëm për të garantuar që skeletkurrikulat të reflektonin nevojat aktuale dhe perspektivat e ardhshme të sektorit të TIK, duke siguruar formimin e profesionistëve të aftë, konkurrues dhe të ndërgjegjshëm për qëndrueshmërinë mjedisore. Ndaj ishte e rëndësishme që këto dokumenta përveç validimit në Komitetin Sektorial të TIK për përmbajtjen teknike specifike, të validoheshin në tërësi nga Komiteti Sektorial i Energjisë në lidhje me tranzicionin e gjelbër.

Pjesa e dytë e takimit u përqëndrua në prezantimin e strukturës aktuale të ofrimit të kualifikimeve profesionale në tërësi dhe më pas specifikisht për çdo kualifikim profesional në fushën e Elektroteknikës. Gjithashtu, anëtarët u informuan se, nga vizitat e përvitshme që AKAFPK kishte kryer në shkollat e mesme profesionale kishte rezultuar se, asnjë nxënës nuk e ndëpriste arsimin pas dy viteve të para, për të hyrë në tregun e punës si ndihmës, por të gjithë vijonin ndjekjen e kualifikimeve të niveleve më të larta, dhe po kështu nga kontaktet e vazhdueshme me bizneset në fushë ishte evidentuar se, tregu i punës i mbulonte nevojat me ndihmës me persona të pakualifikuar, ndaj nuk ishte nevoja për kualifikime përkatëse profesionale për këto pozicione pune.

Anëtarët u informuan se, për këtë arsye në fillim të vitit 2026 ishte zhvilluar një takim konsultues që kishte bërë bashkë tri palët: shkollat e mesme profesionale që ofrojnë kualifikimet e Elektroteknikës në rang vendi, përfaqësues të bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushë dhe përfaqësues të AKAFPK-së. Takimi kishte në fokus diskutimin mbi strukturën ekzistuese të ofrimit të kualifikimeve profesionale në fushën e Elektroteknikës dhe rezultoi me disa propozime për ndryshimin e strukturës aktuale. Anëtarët u informuan mbi propozimet e takimit që ishin si më poshtë:

- Kalimi nga struktura 2+1 dhe 2+1+1 drejt strukturës bllok 3 ose 4 vjeçare.
- Kualifikimet profesionale: *“Instalime elektrike civile dhe industriale”*, *“Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë”*, *“Elektromekanikë”* dhe *“Telekomunikacion”* të ofroheshin si kualifikime bllok me kohëzgjatje 3 vjeçare.
- Kualifikimet profesionale ekzistuese: *“Teknologji automatizimi”* dhe *“Mekatronikë”* të bashkoheshin në një kualifikim të vetëm bllok 4 vjeçar.
- Kualifikimet profesionale: *“Riparime të pajisjeve elektronike”* dhe *“Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake”* të bashkoheshin në një kualifikim të vetëm bllok me kohëzgjatje 4 vjeçare.

Anëtarët miratuan propozimet e takimit konsultues dhe dakordësuan që në mbledhjen e ardhshme të diskutohej sërish emërtimi i kualifikimit profesional që do të bënte bashkë dy kualifikime profesionale: *“Riparime të pajisjeve elektronike”* dhe *“Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake”*.

Në vazhdim anëtarët diskutuan për mundësitë e ofrimit të kualifikimit profesional “*Energji e rinovueshme*”, niveli V në KSHK dhe vështirësitë që haste ofrimi i këtij kualifikimi nga shkollat e mesme profesionale, për shkak të mungesës së bizneseve të mirëfillta në Shqipëri për prodhimin e energjisë së erës dhe mungesës së laboratorëve në shkollë për realizimin e praktikave. Nga diskutimet u dakordësua që të zhvilloheshin takime më të ngushta mes anëtarëve për të diskutuar më hollësisht mbi gjetjen e mundësive të bashkëpunimit mes shkollës së mesme profesionale në Tiranë dhe bizneseve që mund ta mbështesnin.

Në pjesën e fundit të takimit u zhvillua procesi i validimit të dokumenteve të hartuara nga AKAFPK. Pas prezantimit dhe diskutimeve, u validuan standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale në fushën e Elektroteknikës, duke u propozuar vetëm disa përmirësime terminologjike pa ndryshime përmbajtësore.

Gjithashtu, u dakordësua që, takimi i ardhshëm të fokusohet në diskutimet për eficiencën e energjisë dhe mundësitë për ofrimin e kualifikimeve përkatëse për të plotësuar nevojat e tregut lidhur me këto aspekte, si dhe validimi i dokumenteve të tjera që AKAFPK do të hartonte.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U konstatua që skeletkurrikulat “*Multimedia*”, “*Programim*”, “*Zhvillimi website*” dhe “*Tregti e-commerce (elektronike)*” përmbanin koncepte të zhvillimit të qendrueshëm, optimizimit të burimeve digjitale, reduktimit të konsumit të energjisë dhe promovimit të zgjidhjeve inovative me ndikim më të ulët mjedisor.
- U miratua ndryshimi i strukturës së ofrimit të kualifikimeve profesionale në fushën e Elektroteknikës nga 2+2 dhe 2+1+1 në strukturën 3+1 dhe 4 vjeçare bllok si më poshtë:
 - kualifikimet profesionale: “*Instalime elektrike civile dhe industriale*”, “*Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë*”, “*Elektromekanikë*” dhe “*Telekomunikacion*” të ofroheshin si kualifikime bllok me kohëzgjatje 3 vjeçare;
 - kualifikimet profesionale: “*Teknologji automatizimi*” dhe “*Mekatronikë*” të bashkoheshin në një kualifikim të vetëm bllok 4 vjeçar;
 - kualifikimet profesionale: “*Riparime të pajisjeve elektronike*” dhe “*Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake*” të bashkoheshin në një kualifikim të vetëm bllok me kohëzgjatje 4 vjeçare, me mundësinë për të rishikuar emërtimin e kualifikimit.
- U validuan Standardet e Profesioneve: “*Elektracist në banesa dhe të tjerë të ngjashëm*” dhe “*Instalues dhe mirëmbajtës të linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë*”.
- U validuan Standardet e Kualifikimeve Profesionale: “*Instalime elektrike civile dhe Industriale*”, niveli III në KSHK dhe “*Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë*”, niveli III në KSHK.